



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16967/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Osman Gashi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik Ligji nr.03/L-151, e në bazë të nenit 73,74,195,199 të LMK-ës, me datën 16.09.2010, merrë këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Osman Selim Gashi i lindur më 07.03.1962 në Mramor, jeton në Prishtinë rr. Bajram Bahtiri nr.148, DR shkencave filologjike-Dekan i fakultetit filologjik në Prishtinë, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes mesatare ekonomike, deri më tani thot jo i denuar.

Është përgjegjës

Sepse si zyrtar i lartë publik nuk e ka deklaruar Agjensionit kundër korrupsionit në Prishtinë pasurinë për vitin 2009 në afatin ligjor deri më dt.31.03.2010. Me veprim të tillë ka kryer kundërvajtje nga neni 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik Ligji nr.03/L-151. Andaj për këtë:

GJOBITET

Me gjobë në shumë prej: 800 (Tetëqind) Euro.

Gjobën e shqiptuar i pandehuri është e obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë në favor të AQF i Drejtësisë në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-70000515.

Po qe se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njejta do ti zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (Tridhjet ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi.

Në emër të paushallit i pandehuri është e obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro në afat të njejtë sikurse gjobën në të njejtën llogari rrjedhëse.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr.01/2304/10 të dt.08.06.2010, për ndërmarrjen e procedurës kundërvajtëse kundër të lartëpërmendurit dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja inicioi procedurën kundërvajtëse u muar në pyetje i pandehuri i lartëshenuar i cili në mbrojtjen e vet deklaroi: Është e vërtetë se që Agjensionit kundër korrupsionit nuk e ka deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor deri më 31.03.2010, për shkak se nuk ka pasur informacion të plotë për këtë, vërtetë që e ka marrë këtë informatën shumë vonë. Pas afatit ligjor që ka përgatitë dokumentacionin për deklarimin e pasurisë në Agjensionin kundër Korrupsionit por agjensioni i cekur që nuk e ka pranuar pas afatit.

Me kërkesën e ushtruar, marrjen në pyetje të pandehurit, si dhe provat e prezantuara në lëndë është konstatuar se që i pandehuri ka bërë kundërvajtje ashtu siqë edhe e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe është denuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK ndaj të pandehurit i shqiptoi gjobën sipas peshës së kundërvajtjes së kryer, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit te i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njejtit dhe pa taksë.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Më.16.09.2010

GJYQTARJA

Melhiate Devexhi

